

Master i Shkencave në **Dizajn të Aplikuar** (120 ECTC, 2 vite akademike)

Profili kulturor dhe profesional

- Ky program studimi synon të japë njohuri të thelluara në konceptet aplikative të dizajnit të cilat kontribuojnë në krijimin e një eksperti me formim të ri. Nisur edhe nga përvoja ndërkombetare lidhur me raportin që shkollat e artit dhe të dizajnit kanë me ato të arkitekturës mendojmë se krijimi i programit të studimit për dizajnin e aplikuar krahas asaj të arkitekturës do të ndihmonte reciprokisht të dy këto programe studimi, pasi do të përforconte dimensionin e dizajnit në një shkollë me bazament arkitekturen siç është Universiteti POLIS. Propozimi i paraqitur në këtë program studimi krijon këtë profil të ekspertit të fokusuar në aspektet aplikative të dizajnit të objekteve me vlera praktike dhe në këtë kuptim është një risi. Dizajni i aplikuar konsiderohet si ndërthurja e veprimtarive formuese që lidhen me dy komponentë kryesore: arteve të aplikuara dhe inxhinierisë. Si të tilla konsiderohen dizajni industrial, dizajni grafik, dizajni interierit, artet e aplikuara, multimedia, si edhe artet funksionale. Shpesh këtu klasifikohet edhe arkitektura dhe fotografia.

Temat kryesore që trajton ky program studimi:

- *Formim i përgjithshëm*
Histori dhe teori arti dhe dizajni e avancuar; Studio dhe Teori Arkitekture Interieri; Thellim Teorik Artit Modern & Dizajnit të Aplikuar; Metoda të kërkimit Shkencor; Sipërmarrja, Biznesi (Menaxhimi i Inovacionit);
- *Formim në kulturën artistike bazë dhe nga fusha të tjera*
- Dizajni Grafik; Gjeometri e Avancuar në Arkitekturë, Dizajni Dixhital 3D dhe Parametrik: Teknika & Programe Grafike Kompiuterike;
- *Formim në gjini të veçanta të artit dhe të dizajnit*
Studio Arkitekture Interieri (Metoda, Materiale, Mobilimi, Ndricimi); Dizajn Grafik dhe Industrial; Prodhimi, Paketimi, Marketim dhe Branding i Produktit; Dizajn Multimedial; Fushatë Promovimi Imazhi dhe Company Branding; Film Research

Mundësitë për punësim

Sektorët kryesorë të punësimit përfshijnë:

- Sektori privat i studiove artistike; artistë të pavarur përfshi edhe pjesën aplikative të artit; "industria" e marketimit, e botimeve, e mediave në përgjithësi, e veshjeve, e modës, e prodhimit të mobiljeve, dizenjuesi si personi që kuron imazhin; në fushën e dizajnit të interiereve të banesave dhe lokaleve etj
- Sektori publik: në nivelet e ndryshme të qeverisjes, për të trajtuar me një frymë të re çështjet që kanë të bëjnë me edukimin e shijes estetike dhe që kanë një shkallë të lartë të impaktit shoqëror.

Plani Mësimor si më poshtë vijon:

Plan Mësimor sipas tipeve të veprimtarive i programit të studimit

Master i Shkencave në Dizajn të Aplikuar

Fusha disiplinore	Veprimtari formuese	Kredite	Kredite total	Kredite (%)
A (formim baze i pergjithshem)	Histori dhe Teori e Dizajnit 1 (Histori dhe Psikologji e dizajnit)	6	15	13%
	Histori dhe Teori e Dizajnit 2 (Thellim Teorik I Artit Modern dhe Dizajnit te Aplikuar)	6		
	Metoda te kerkimit Shkencor	3		
B (karakterizuese)	Studio dhe Teori Arkitekture Interieri	6	45	38%
	Introduction to Marketing	6		
	Brand Communication (Fushate Promovim Imazhi dhe Branding)	6		
	Dizajn Multimedial i Avancuar 1	6		
	Dizajn Multimedial i Avancuar 2 (Dizajn Dixhital 3D)	6		
	Projektim/Alestim	3		
	Gjeometri e Avancuar ne Arkitekture, Teknika Baze te Vizualizimit dhe Dokumentimit Grafik	6		
	Dizain Grafik dhe Industrial	6		
C (integruese)	Advanced Modeling (CAD, Dizajni Dixhital 3D , Perspektiva & Renderimi Interierit)	6	12	10%
	Advanced Modeling - Animation	6		
D (me perzgjedhje)	Lende me perzgjedhje 1	6	12	10%
	Lende me perzgjedhje 2	6		
E (formuese plotesuese)	Dizajni Dixhital 3D dhe Parametrik: Teknika & Programe Grafike Kompiuterike	6	12	10%
	Internship Profesional	6		
F (Pergatitja tezes)	Teza dhe Projekt Diploma	24	24	20%
	TOTAL	120	120	100%